



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULATOR I ENERGJISË**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 141, Datë 16.07.2024**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË  
“BMG ENERGY SAL” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT  
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregulator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.07.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1569/1prot., datë 10.07.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “BMG ENERGY SAL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “BMG ENERGY SAL” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1569 prot., datë 01.07 2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 të Rregullores për pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 gërmën “c”; për pikën 2.1 gërmat “b”, “c”, “d”, dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “BMG ENERGY SAL” sh.p.k.:
  - Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Kontratën nr. 3247 rep., nr. 2138 kol., datë 02.06.2023 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria “BMG ENERGY SAL” sh.p.k.”;
  - Ka nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” marrëveshjen nr. 9511/2 prot., datë 13.10.2023, për lidhjen e centralit fotovoltaike të shoqërisë “BMG ENERGY SAL” sh.p.k. me rrjetin e shpërndarjes.
- Nga ky aplikimi nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni në vijim:

## NENI 9

### **Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë**

#### *Pika 1.2*

- **gërma “b”:** Vërtetimi për vetë shoqërinë duhet të depozitohet me datë të përditësuar dhe i lëshuar jo më vonë se 1 muaj nga paraqitja e aplikimit.

#### *Pika 1.3*

- **gërma “a”:** Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin përkatës që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
- **gërma “b”:** Shoqëria duhet të saktësojë/sqarojë ndryshimet e mënyrës së financimit të projektit, si dhe të depozitojë vendimet përkatëse të organeve drejtuese të saj dhe të ortakut të vetëm të saj në lidhje me financimin e projektit.

### **Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës**

#### *Pika 2.1*

- **gërma “a”:** Shoqëria duhet të bëjë saktësimet përkatëse në numrin e njësive gjeneruese dhe kapacitetin e instaluar të secilës, të depozitojë dokumentacionin teknik në lidhje me jetëgjatësinë e centralit fotovoltaike, si dhe të përcaktojë një datë konkrete për operimin e centralit.
- **gërma “e”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentin përkatës të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), VNM Paraprake, Deklaratë Mjedisore etj.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “BMG ENERGY SAL” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “BMG ENERGY SAL” shpk dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**